

V E N D I M
Nr. 242, datë 6.6.2002

PËR KRIJIMIN E ZYRAVE RAJONALE TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e zyrve rajonale të turizmit (ZRT), në përbërje të prefekturave të qarqeve: Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë.

2. Zyrat rajonale të turizmit ushtrojnë këto detyra:

- Hartojnë strategji rajonale, në përputhje me strategjinë e përgjithshme, të miratuar, të zhvillimit turistik të vendit dhe ndihmojnë në realizimin e tyre;

- mbikëqyrin veprimtaritë turistike rajonale, mbështesin kontrollin për vëzhgimin e rregullave të etikës profesionale në fushën e turizmit;

- ofrojnë objekte turistike për kategorizimin e tyre, në përputhje me kriteret e vëna nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

- shpërndajnë të dhëna dhe kryejnë veprimtari promociionale, rajonale;

- ndihmojnë në grumbullimin e statistikave dhe të dhënave turistike në rajonin ku veprojnë;

- kontrollojnë realizimin e investimeve në zonat ku janë miratuar dhe kryejnë shërbimin këshillimor për procedurat e miratimit të projekteve të reja investuese në zonat turistike;

- raportojnë një herë në muaj në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për të gjitha problemet.

3. Në strukturat organike të prefekturave të qarqeve Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë të shtohet nga një punonjës për të mbuluar veprimtarinë e zyrve rajonale të turizmit.

4. Zyrat rajonale të turizmit, administrativisht, janë në varësi të prefektit të qarkut, ndërsa përsa i përket drejtimit metodik, ato varen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

5. Veprimtaria, funksionimi, procedurat e emërimit dhe detyrat organizative të këtyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

6. Përjashtimisht, për vitin 2002, efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, si dhe prefektët e qarqeve Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko